



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Punëjeto/Prodato Received/Delivery	27.09.2022	2	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKUPSHINA	5711/2022		115



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Nezavisni Nadzorni Odbor Civilne Službe Kosova
Independent Oversight Board for the Civil Service of Kosovo

A.nr.704/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë me Zyle Millaku Gojnovci - Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.704/2022 të datës 15.08.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë:

kundër Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në çështjen juridike "Transferim", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 27.09.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.704/2022 e datës 15.08.2022 e parashtruar nga ankuesi

II. Shfuqizohet Vendimi Nr.116/2022 i datës 19.08.2022 i Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

III. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrinë se Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, duke e kthyer ankuesin në pozitën e tij sipas Akt Emërimit të datës 26.12.2014 me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lidhen nga marrëdhënia e tij e punës.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi [redacted] i punësuar në pozitën e punës "Drejtor i Prokurimit" pranë Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, me datë 12.08.2022 me Vendimin Nr.98/2022 të Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm, është transferuar përkohësisht për periudhë gjashtë (6) muaj në pozitën "Udhëheqës i Divizionit për Komunikim me Publik" në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Kundër Vendimit Nr.98/2022 të datës 12.08.2022 të Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës, ankuesi me datë 15.08.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 4701/2022 të regjistruar nën shenjen A.nr.704/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimet ankimore se vendimi i atakuar është i kundërligjshëm për shkak të mohimit të drejtave elementare të punës, mohimit të njoftimit paraprak si dhe shkeljes së afateve të përcaktuara ligjore në rastet e transferimit të përkohshëm. Ndërsa me datë 23.08.2022 i njëjti ka bërë plotësimin e ankesës me numër protokoll 4881/2022 të datës 15.08.2022 në kuptim të precizimit të aktit administrativ të atakuar, me pretendime të njëjta ankimore ankuesi kundërshton Vendimin Nr.116/2022 të datës 19.08.2022 të nxjerrë nga Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës përmes të cilit është shfuqizuar Vendimi Nr.98/2022 i datës 12.08.2022, ndërsa ankuesi është transferuar përkohësisht për periudhë gjashtë (6) muaj nga pozita "Udhëheqës i Divizionit të Prokurimit" në pozitën "Udhëheqës i Divizionit të Inspektimit për Infrastrukturë Rrugore", në Departamentin e Inspektimeve në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, më datë 22.08.2022 dhe me 21.09.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ndërsa kjo e fundit më datë 30.08.2022 dhe me 21.09.2022 ka dërguar shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave për marrjen e vendimit meritor administroi këto prova: Ankesa e datës 15.08.2022 me numër protokoll 4701/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr.98/2022 të datës 12.08.2022 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës; Plotësim i ankesës me datë 23.08.2022 me numër protokoll 4881/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Shkresa e datës 15.08.2022 për pezullimin e efektit të Vendimin me Nr.98/2022 të datës 12.08.2022; E-mail i datës 15.08.2022; Vendimin me Nr.98/2022 të datës 12.08.2022 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit, Hapësinor dhe Infrastrukturës; Vendimin me Nr.01-148 të datës 11.01.2021; Autorizimi i datës 11.09.2019, me përshkrim të detyrave të punës e datës 10.09.2019; Përgjigje nr. protokoll 5033/22 në ankesë e datës 30.08.2022; Përshkrim i detyrave të punës i datë 07.08.2011, me prova shtesë E-mail të datës 21.09.2022; Vendimi Nr.116/2022 i datës 19.08.2022; Vendimi me numër protokoll 3452 i datës 23.04.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës ka konstatuar se ankesa e ankuesit, është e bazuar sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, nga administrimi i shkresave të lëndës ka gjetur se ankuesi sipas Aktit të Emërimit të nënshkruar të datës 26.12.2014 është emëruar Drejtor i Prokurimit në Ministrinë e Infrastrukturës me koeficient të pagës dhjetë (10). Më tej, nga provat e lëndës rezulton se me Vendimin Nr.98/2022 të datës 12.08.2022 të Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës, ankuesi është transferuar përkohësisht për periudhë gjashtë (6) muaj në pozitën "Udhëheqës i Divizionit për Komunikim me Publik" në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ndërsa me datë 19.08.2022 Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm ka nxjerre Vendimin Nr.116/2022 me të cilin është shfuqizuar Vendimi Nr.98/2022 i datës 12.08.2022, ndërsa ankuesi është transferuar përkohësisht për periudhë gjashtë (6) muaj nga pozita "Udhëheqës i Divizionit të Prokurimit" në pozitën "Udhëheqës i Divizionit të Inspektimit për Infrastrukturë Rrugore", në Departamentin e Inspektimeve në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës, me arsyetimin e mbarëvajtjes së punës dhe në funksion të koordinimit dhe kryerjes së detyrave dhe përgjegjësi në Departamentin e Inspektimeve.

Ankuesi në ankesën e tij të parashtruar me datë 15.08.2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, sikurse edhe në plotësimin dhe precizimin e ankesës me datë 23.08.2022, pretendon se organi i punësimit me rastin e transferimit të përkohshëm të tij ka vendosur në mënyrë të gabuar dhe jo të drejt duke vepruar kështu në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Rregullores Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë si dhe ligjeve tjera relevante.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ngritura në ankesë, Kolegji ju referua dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 2 paragrafin 2.1 ku përcaktohet se: *Nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozitë tjetër të Shërbimit Civil të së njëjtës kategori, në këto raste: 1.1. kur është në interes të institucionit, deri në 6 muaj gjatë 2 vjetëve. Transferimi mund të bëhet: 2.1. brenda institucionit ku është emëruar, duke përfshirë këtu edhe degët e tij lokale, dhe nenit 5 paragrafit 2 të Rregullores (QRK) Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë ku është përcaktuar se: "Transferimi i përkohshëm në interes të institucioni, miratohet nga njësia përgjegjëse, e cila njofton me shkrim nëpunësin civil që do të transferohet. Për marrjen e këtij vendimi njësia përgjegjëse mbështetet në analizën e plotësimit nga ana e nëpunësit të kritereve të pozitës të punës ku ai kërkohet të transferohet", dhe rrjedhimisht Kolegji vlerëson se organi i punësimit ka të drejtë që nëpunësin civil ta transferojë përkohësisht për interes të institucionit, mirëpo në kuptim të nenit 52 paragrafi 7 të të njëjtit ligj, si dhe nenit 5 paragrafi 2 të Rregullores Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil, Kolegji konstaton se transferimi i përkohshëm në interes të institucionit është në kompetencë të njësisë përgjegjëse.*

Sipas dispozitave të nenit 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, njësi përgjegjëse në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit, Hapësinor dhe Infrastrukturës është Njësia për Burime Njerëzore. Njësia e Burimeve Njerëzore, si njësi përgjegjëse në rastet e tilla njofton me shkrim nëpunësin civil që do të transferohet, dhe se për marrjen e këtij vendimi njësia përgjegjëse mbështetet në analizën e plotësimit nga ana e nëpunësit të kritereve të pozitës të punës ku ai kërkohet të transferohet.

Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lëndës ka gjetur se vendimi për transferimin e ankuesit nga pozita e punës "Udhëheqës i Divizionit të Prokurimit" në pozitën e punës "Udhëheqës i Divizionit të Inspektimit për Infrastrukturë Rrugore", nuk është miratuar nga organi kompetent, gjegjësisht Njësia e Burimeve Njerëzore, respektivisht kjo e fundit në përgjigjen e datës 30.08.2022 ka theksuar se citoj „Ju njoftoj se lidhur me transferimin e _____ nuk janë zhvilluar procedurat e transferimit nga Divizioni për Burime Njerëzore, po ashtu ju informoj se ne si Divizion nuk posedojmë ndonjë dokument apo dëshmi lidhur me veprimet juridike si dhe me pajtimin ose mospajtimin e ankuesit lidhur me transferimin e tij”. Rrjedhimisht sipas shkresave të lëndës nga organi i punësimit nuk është dhënë asnjë arsytim në lidhje me marrjen e kompetencës së njësisë përgjegjëse nga udhëheqësi me i lartë administrativ. Andaj në kuptim të dispozitave ligjore të lartpërmendura si dhe bazuar në këtë konstatim Kolegji i Këshillit vlerëson se vendimi për transferimin e përkohshëm të ankuesit, respektivisht akti i kontestuar me Nr.116/2022 është nxjerr nga organi jo kompetent përkatësisht vendimi është nxjerr nga Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm e jo nga Udhëheqësi i Njësisë së Burimeve Njerëzore si organ kompetent, dhe si i tillë është i paligjshëm në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafit 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, andaj mbi këtë baze pretendimi ankimor i ankuesit është i drejt dhe i bazuar.

Ndërsa lidhur me pretendimin ankimor të ankuesi për shkelje të ligjit material në kuptim të tejkalimit të afatit të përcaktuar ligjor për transferim të përkohshëm, Kolegji i Këshillit ka analizuar shkresat e lëndës dhe si rrjedhojë ka gjetur se ankuesi sipas Vendimit me numër 01-148 të datës 11.01.2021 edhe më parë ka qenë i transferuar përkohësisht nga pozita "Udhëheqës i Divizionit të Prokurimit", në pozitën "Udhëheqës i Divizionit për Koordinimin e Politikave", për periudhën kohore prej tre (3) muajve, andaj në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit transferimi i fundit i ankuesit përmes Vendimit Nr.116/2022 të datës 19.08.2022 është në kundërshtim me dispozitat e ligjit material, gjegjësisht dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarë Publikë, përkatësisht nenin 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 ku përcaktohet se: ***Nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozitë tjetër të Shërbimit Civil të së njëjtës kategori, në këto raste: 1.1. kur është në interes të institucionit, deri në 6 muaj gjatë 2 vjetëve***, sepse sipas shkresave të lëndës ankuesi nga transferimi i parë në periudhë prej tre (3) muajve, i njëjti është transferuar përsëri edhe për një afat prej gjashtë (6) muajsh që gjithsejtë janë 9 muaj brenda 2 viteve, e që është në kundërshtim me dispozitat e nenit nenin 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarë Publikë.

Andaj, për sa me sipër e duke u bazuar në dispozitat e nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, dhe 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit konstaton se Vendimi Nr.116/2022 i datës 19.08.2022 është akt administrativ i paligjshëm, kështu që me qëllim të kthimit të ligjshmërisë, duke u bazuar në nenin 55 paragrafët 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi për aprovimin e ankesës dhe rrjedhimisht shfuqizimin e aktit administrativ të kontestuar, duke detyruar njëkohësisht organin e punësimit që ankuesin ta kthejë në pozitën e tij sipas Akt Emërimit të datës 26.12.2014 me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lidhen nga marrëdhënia e tij e punës.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda A.nr.704/2022.

Zyle Millaku GOJNOVCI

Procesmbajtëse

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit, Hapësinor dhe Infrastrukturës ;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit, Hapësinor dhe Infrastrukturës,
- Arkivit të KPMSHCK- së.

